LIGJ
Nr. 103/2018

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9643, DATË 20.11.2006, "PËR PROKURIMIN PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 45 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.".

2. Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

"Me qëllim plotësimin e kushteve të parashi-kuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) vërtetim mbi gjendjen gjyqësore ose një dokument, të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shkronjat "a", "b" dhe "c"."

3. Kudo ku përmenden, në titull dhe në përmbajtjen e këtij neni, fjalët "kandidatë ose ofertues" zëvendësohen me fjalët "operator ekonomik".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11007, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta